



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1036/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Halit Zeneli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, tw cilin e pwrfaqwson sipas autorizimit Florin H. Shefqeti avokat nga Prishtina, Rruga “Fehmi Agani”, Nr.79/8, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1036/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Halit Zeneli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për Qendrat e Votimit QV 1935E, QV 1920X.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në Qendrat e Votimit: QV 1935E, QV 1920X.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat e Votimeve, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit Anr.1036/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Halit Zeneli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për rinumërim te fletëvotimeve ne Qendrat e

Votimit QV 1904E, QV 1930E, QV 1936E, QV 1927E, QV1920E, QV1921E, 1922E, QV 1919E, QV 1901E, QV1914E, QV 1906E, 1953E, 1931E.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për Kuvend Komunal Halit Zeneli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, në të cilin ndër të tjera pretendon se në qendrat e votimeve 1904E, 1929E, 1920X, 1930E, 1935E, 1936E, 1927E, 1920E, 1921E, 1922E, 1919E, 1901E, 1914E, 1906E, 1953E, 1931E, ka pasur parregullsi, pasi që ka pasur mospërputhje të rezultateve dhe shumë nga votat nuk i janë shfaqur në shumë shkolla në Komunën e Prishtinës, prandaj konsideron se ka pasur keqpërdorime të votave. Në apel ka bashkangjitur deklaratat të votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Halit Zeneli, kërkon rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit të lartcekura. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Halit Zeneli Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilin apel kërkon që ti rinumërohen votat në qendrat e votimit të lartcekura është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Rezultatet përfundimtare nga KQZ, të Kandidatëve në Qendrat e Votimit QV 1935E, QV 1920X, nuk përputhen votat në këto Qendra të Votimit, me deklaratat e votuesve të bashkangjitur në shkresat e lëndës. Në Qendrën e Votimit QV 1935E, për kandidatin në fjalë në rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së, ka rezultuar se nuk ka vota, ndërsa në shkresat e lëndës kemi të bashkangjitur deklaratën e Votuesit Endrit Gashi i cili deklaroi se ka votuar në këtë qendër për kandidatin Halit Zeneli. Në Qendrën e Votimit QV 1920X, nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së, ka rezultuar se nuk ka gjithsej 20 vota, ndërsa në shkresat e lëndës kemi të bashkangjitur 23 deklaratat nga Votuesit të cilët dëshmojnë se kanë votuar në këtë Qendër, për kandidatin Halit Zeneli. Sipas deklaratave të votuesve të bashkangjitura në

apel e që ndërliiden me këto QV, kemi me shumë deklaratat si dëshmi që deklarojnë se kanë votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratat e votueseve, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit, paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit lidhur me deklaratat e dorëzuara për QV-të e vendosura në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, i shqyrtoi deklaratat për secilën Qendër të Votimit dhe erdhi në përfundim se në këto Qendra të Votimit ka më shumë vota se sa deklaratat të votuesve për secilën Qendër të Votimit veç e veç. Në rastin konkret apeluasi me asnjë provë shkresore nuk ka argumentuar se në QV-të si në pikën IV të dispozitivit, ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, sepse deklaratat e bashkangjitura për këto

Qendra të Votimit, janë më pak se sa ka vota ankuesi, e që rezulton se deklaratat për këtë pjesë nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme, për të dëshmuar ne realitet se do te kishte vota me shumë se ato që i ka ne fakt te konstatuara si ekzistuese, prandaj u vendos si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që deklaratat e votuesve të bashkangjitura në këtë rast nga ankuesi, janë vlerësuar nga paneli si deklarata të karakterit informues se votuesit që kanë deklaruar edhe kanë votuar për ankuesin ashtu që nga rezultati i dal në QV-të, e vendosura në pikën IV të dispozitivit, ankuesit nuk i mungon asnjë votë, përkundrazi ka më shumë vota sesa deklarime të bashkangjitura.

Prandaj me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, dhe nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1036/2021 më datën 07.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.